

“SHOPPING” ME TAKSA TË QYTETARVE

Raporti i Monitorimit të Prokurimit Publik- Komuna e Prizrenit



JANAR 2015



|||||

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes qytetare në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI-së ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

COPYRIGHT © 2014. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

|||||

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROKURIMIN E KOMUNËS SË PRIZRENIT	6
Të gjeturat e zyrës së auditorit të përgjithshëm	6
Praktikat e Mira.....	7
TENDERI PËR MIRËMBAJTJEN E RRUGËVE.....	7
TENDERI PËR FURNIZIM ME NAFTË.....	10
TENDERI PËR NDËRTIMIN E RRUGËS BESËLIDHJA ME KUBZA BETONI.....	12
KONKLuzionet	14

|||||

HYRJE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/Transparency International Kosova (TIK), ka filluar iniciativën e monitorimit të prokurimit publik në nivel lokal, përkatësisht në 5 (pesë) komuna të Republikës së Kosovës. Ko iniciativë ka lindur pas monitorimit të nivelit qendror, përkatësisht 4 (katër) ministrive të Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Infrastrukturës (MI) dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Në këto ministri, KDI kë arritur rezultate në evidentimin e problemeve në prokurimin dhe ka avokuar në organet vendimmarrëse, për përmirësimin e shumë dobësive që kanë përcjell këtë proces. Po ashtu KDI ka bërë procedimin e një numri të konsiderueshëm të rasteve në Prokurorinë e Shtetit, ku ka pasur dyshime se shkeljet janë kryer me qëllim të dëmtimit të qëllimshëm të buxhetit publik.

KDI-ja vazhdon të monitoroj prokurimin publik në 5 (pesë) komuna të Kosovës përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Gjakovën, Gjilanin dhe Mamushën. Këto 7 (shtatë) komuna, janë përzgjedhur nga KDI, duke pasë parasysh përfaqësimin politik dhe etnik. Të dhënat e mbledhura për tre lloje tenderësh (tenderët e furnizimit me naftë, mirëmbajtjen e rrugëve dhe një tender për shtrim të rrugëve me kubëza të betonit) do të krahasohen për çmimet e kontratave, në mënyrë që të merret parasysh se me çfarë vlere paguhen produktet e njëjta nga komunat e ndryshme. Gjithashtu do të krahasohen dosjet e tenderëve për të parë se çfarë specifikacione dhe kërkesa kanë komunat e ndryshme në raport me bizneset. Kjo bëhet me qëllim për të parë nëse janë sa duhet të detajuara kërkesat e komunave ose jo dhe në anën tjetër nëse bizneset rëndohen me kërkesa të panevojshme ose kërkesa të cilat ulin konkurrencën apo favorizojnë operatorë ekonomik të veçantë.

Synimi i KDI është që përmes këtyre analizave të ndihmojë komunat të marrin vlerën për paratë publike të shpenzuar dhe për të evidentuar barrierat administrative për operatorët ekonomikë të cilat dobësojnë konkurrencën e drejtë. Gjithashtu KDI synon t'i informoj qytetarët lidhur me formën se si komunat e tyre kanë administruar me buxhetin e besuar dhe cilat kanë qenë kompanitë që kanë përfituar kontrata publike nga komunat.

|||||

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROKURIMIN E KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit është komuna me buxhetin më të lartë në Kosovë, pas Komunës së Prishtinës. Prizreni ka një buxhet të përgjithshëm prej 35,877,659. Prej këtyre mjeteve, 15,841,983 euro janë të destinuara për shpenzime kapitale, ndërsa 3,172,120 mallra dhe shërbime. Mjetet për investime kapitale dhe ato për mallra dhe shërbime që në këtë rast kapin shifrën e rreth 19 milion eurove shpenzohen përmes prokurimit publik. Pjesa tjetër e mjeteve shpenzohen për paga dhe mëditje, subvencione, shpenzime komunale etj.

Komuna e Prizrenit për këtë vit ka pasur 80 procedura tenderuese, apo njoftime për kontratë në KRPP, ndërsa 112 njoftime për dhënien e kontratës. Kjo do të thotë se 32 projekte nuk ka pasur njoftim për kontratë, përkatësisht konkurrenca për bizneset ka qenë e limituar. Kjo për shkak se tenderët qoftë kanë pasur vlera minimale apo shuma e tyre ka qenë nën 10 000 euro. Në anën tjetër ka pasur 18 njoftime për anulimin e njoftimeve për kontratë, që gjithashtu është e dhënë shqetësuese për prokurimin e komunës së Prizrenit. Numri i madh i tenderëve të anuluar flet për efikasitet të dobët në menaxhim të procedurave tenderuese. Komuna e Prizrenit në anën tjetër argumenton se anulimi i procedurave tenderuese, ka parandaluar shkeljet eventuale të ligjit. Në vitin 2013 asnjë tender i komunës nuk është monitoruar nga KRPP, përkundër që komuna e Prizrenit është shpenzuesi i dytë në nivel lokal pas Komunës së Prishtinës.

TË GJETURAT E ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Dobësitë sistematike ekzistojnë në fushën e prokurimit, që nga zotimi i fondeve, ndjekja e procedurave të prokurimit e deri te menaxhimi i kontratave. Procesi i menaxhimit të kontratave është përcjell me kontrolle joadekuate, raporte pa specifika të qarta si dhe mungesë të pranimit teknik të punëve të kryera;

Te Kontrata “Ndërtimi i stadiumit të qytetit” në shumë prej 193,623€, shuma e zotuar për këtë projekt ishte vetëm 20,000€. Raste të lidhjes së kontratave pa zotim të mjaftueshëm kemi gjetur edhe në 23 mostra të testuara. ZKF nuk kishte ndonjë koment për rastet e tilla; Te kontrata “Asfaltimi i rrugës Piranë-Reti” në vlerë prej 167,137€ sipas planit dinamik, projekti ishte paraparë të përfundoj për 50 ditë pune. Ne kemi vërejtur se ky afat nuk ishte respektuar. Deri në kohën e auditimit, kjo vonesë kishte arritur në 250 ditë kalendarike. Sipas pohimeve të menaxhmentit, mungesa e fondeve për këtë projekt ka bërë që të ngecë puna dhe si i tillë të

mos përfundoj me kohë. Vonesa të tilla kemi gjetur pothuajse në secilin projekt të ekzaminuar. Te kontrata “Ndërtim i rrugës Krushë e vogël – Piranë” në vlerë prej 74,855€ kemi gjetur se fituesi i tenderit ka ofruar sigurimin e ekzekutimit të kontratës për 40 ditë më të shkurt se sa plani dinamik i punimeve. Punimet nuk ishin kryer në afatin e garancionit, ndërsa komuna nuk kishte kërkuar ripërtëritjen e sigurimit të ekzekutimit. Sigurimi ishte bërë me datën 29.04.2013 deri me 08.06.2013 në shumë prej 7,405€.

Në anën tjetër komuna e Prizrenit nuk ka qenë edhe aq komode me numrin e ankesave që janë dorëzuar nga bizneset në Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), për komunën e Prizrenit ka pasur 10 ankesa në vitin 2013, mirëpo për shkak të mungesës së bordit të OSHP-së shtatë (7) nga këto ankesa nuk janë shqyrtuar. Ndërsa nga tre (3) të shqyrtuara dy janë aprovuar ndërsa nje (1) është dërguar në ri-tenderim. Krahasuar me komunat e tjera, komuna e Prizrenit radhitet në komunat me numër të madh të ankesave, së bashku me Gjilanin dhe Prishtinën.

PRAKTIKAT E MIRA

Publikimi i njoftimeve në ueb faqen e Komunës, madje edhe për kuotim të çmimeve në masë të madhe, është një praktikë shumë e mirë të cilën e aplikon komuna e Prizrenit. Shumica e komunave të tjera në Kosovë, nuk publikojnë kuotimin e çmimeve dhe kjo është një indikator që duhet vlerësuar në Komunën e Prizrenit. Kjo mundëson sidomos bizneseve të vogla qasje në tenderët me vlera nën 10.000 euro. Ligji nuk kërkon që këto njoftime të publikohen në ueb faqen e KRPP-së dhe publikimi i tyre me vetë iniciativë të komunës është praktikë e cila duhet të merret si shembull edhe nga autoritetet e tjera kontraktuese.

TENDERI PËR MIRËMBAJTJEN E RRUGËVE

Komuna e Prizrenit, ka zgjedhur tre kompani private për mirëmbajtjen e rrugëve, shesheve dhe trotuareve. Ky tender ka qenë i ndarë në tre lloje dhe ka pasur vetëm tre kompani të cilat kanë tenderuar. Vlera e këtij tenderi është rreth 56,000.00 euro. Kompanitë të cilat kanë aplikuar për këtë tender janë Ekoregjioni, Sherbimi dhe Is-Company. Kontrata është e lidhur për një periudhë prej 36 muajve dhe është kontratë e tipit kornizë, që do të thotë se vlera totale e kontratës përcaktohet nga numri i punëve në terren, andaj shumat mund të jenë më të ulëta apo më të larta, varësisht nga volumi i punëve në terren. Kontratat për mirëmbajtjen e rrugëve janë mjaftë të favorshme për kompanitë, pasi që u sigurojnë qëndrueshmëri në financim. Interes të jashtëzakonshëm zgjojnë rrugët nacionale dhe rajonale, mirëpo edhe

rrugët brenda qyteteve janë profitabile për kompanitë.

Është për t'u habitur fakti se në komunën e Prizrenit ka pasur interesim të vogël të kompanive për të ofertuar. Vetëm kompanitë që kanë fituar në këtë tender kanë aplikuar. Asnjë kompani tjetër nuk ka paraqitur ofertë. Në anën tjetër dosjen e tenderit e kanë tërhequr pesë kompani private, dy prej të cilave fare nuk kanë paraqitur ofertë. Për shkak të shpërblimit me kontratë të tre operatorëve aplikues, asnjëri nga ta nuk është ankuar në OSHP.

Numri	Emri Kompanisë	Numri i rrugëve	Çmimi €
1	Is-Company	27	16,136.00
2	Sherbimi	36	19,909.35
3	Ekoregjioni	27	16,136.00

Dyshimi më i madh në këtë kontratë mbetet harmonizimi i plotë i tre operatorëve për aplikimin e çmimeve për njësi. Në pastrimin e rrugëve të Prizrenit të gjitha kompanitë kanë aplikuar me çmimin e njëjtë, përkatësisht 0.63 euro për M^1 (metër gjatësi). Pjesë a dytë e kontratës, është gjithashtu identike në çmime, pasi që largimi i borës nëpër fshatra është kontraktuar me 40 euro për një orë punë. Këtu po ashtu nuk ka asnjë dallim oferte mes tre operatorëve. Tabela e tretë, përkatësisht mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, çmimi për njësi është 0.14 euro për M^2 në të tri ofertat.

Përveç pjesës së fshirjes, larjes dhe pastrimit nga bora, këto kompani çmimet identike i kanë edhe një pjesën tjetër të tenderit, përkatësisht mbjellja e barit, luleve, shkurreve dhe krastitja e drunjve. 1. Mbjellja e barit 1 euro për M^2 , mbjellja e luleve sezonale dekorative 2.5 euro për M^2 , mbjellja e shkurreve 10 euro për copë, krastitja e drunjëve 8 euro për copë dhe pastrimi i shtratit të Lumëbardhit 20 euro për M^3 . Dallimi i vetëm në mes të këtyre tre kontratave është se në llotin e tretë kemi një shërbim më tepër të kontraktuar për shërbimet e tjera komunale, përkatësisht shërbime për nevojat e Komunës së Prizrenit grumbullimi i mbeturinave, vendosja e flamujve, etj. vlera këto paushallë mjaftë të larta. Për shembull grumbullimi i mbeturinave nga ndërtesa e komunës dhe deponimi i tyre është kontraktuar me 1000 euro në muaj, grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave inerte nga deponitë e egra nëpër qytet 2700 euro në muaj, kurse vendosja e flamujve dhe largimi i tyre me 1200 euro në muaj.

|||||

Ky indikatorë është mjaftë shqetësues pasi që shton dyshimet se tenderi ka mund të ketë qenë i fiksuar apo operatorët të jenë marr veshë paraprakisht për aplikimin e këtyre çmimeve. Cilado të ketë qenë, marrëveshja apo fiksimi tenderit, që të dyja janë të ndaluara si praktika të dëmshme. Mundësia që çmimet e tre operatorëve të jenë të njëjta në kaq shumë kategori është po thuhet e pamundur, në atë formë që secili të marr një llotë dhe në anën tjetër të ketë çmime për njësi të njëjta në kategorinë kryesore që është pastrimi i rrugëve. Në këtë rast mundësia më e madhe është që operatorët të jenë marr veshë me ose pa dijen e autoritetit kontraktues, për të aplikuar në këtë tender, me çmime në atë formë që janë shumë profitabile për kompanitë. Mirëpo edhe nëse kjo ka ndodhur pa dijen e autoritetit kontraktues, sapo të ketë filluar shqyrtimi i ofertave dhe leximi i çmimeve diçka e tillë do të duhej të evidentohet dhe kjo procedurë tenderuese të anulohet për t’u rishpallur. Pasi që kjo nuk ka ndodhur, atëherë rrjedhimisht mund të kuptohet se autoriteti kontraktues është pajtuar me këtë situatë.

Nga qasja në ofertat e kompanive konkurruese, kemi vërejtur se ato kanë ofruar çmime të ndryshme për punët e njëjta varësisht nga llotet. Kjo ka ndodhur për t’u siguruar që secila kompani do të fitoj nga një llot. Në të kundërtën do të ishte e pamundur që rastësisht çmimet të harmonizohen në të gjitha kategoritë në atë mënyrë. Kjo praktikë e fiksimit të çmimeve është e ndaluar në prokurim publik, pasi që është në kundërshtim me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik.

Mungesa e konkurrencës është po ashtu indikatorë tjetër se diçka nuk ka qenë në rregull me këtë tender, pasi që për tre lloje apo pjesë të tenderit ka pasur vetëm tre kompani. Në mesatare kjo i bie një kompani për një llot. Megjithatë secila prej tyre ka paraqitur ofertë për të trija llotet, çmimet kanë pasur dallime minimale në atë formë që secila prej tyre të marr njërin nga pjesët e kontratës.

Problemi i tretë i këtij tenderi, që lidhet prapë me çmimet është forma se si janë kalkuluar këto çmime. Në pjesën e parë të kontratës, çmimet janë mujore, përderisa në pjesë tjera çmimet janë në orë pune. Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve nëpër qytet paguhet me çmimin e caktuar në kontratë në muaj dhe nuk specifikohet numri i intervenimeve që duhet të bëjë kompania.

Në përgjithësi në këtë kontratë mund të konstatohen fiksime të çmimeve nga operatorët ekonomik, konkurrencë e vogël apo mungesë e konkurrencës së ndershme dhe çmime relativisht të larta krahasuar me punët që duhet të kryhen.

|||||

zyrtare dhe jo atyre që sjellin kompanitë.

Për këtë tender në Komunën e Prizrenit, ka pasur shumë pak interesim nga kompanitë që shesin karburante. Vetëm dy kompani kanë aplikuar në këtë tender, njëherit edhe kompanitë kryesore në garën për tender. Hib Petrol dhe Petrol Company, janë të vetmit operatorë që kanë dorëzuar ofertat për këtë tender. Kompania Petrol Company, ka ofertuar me premium prej 15 cent, përderisa Hib Petrol ka pasur ofertë akoma më të shtrenjtë 17 cent për litër. Që të dy operatorët në raportin e vlerësimit i kanë plotësuar të gjitha kushtet e dosjes së tenderit dhe kanë qenë të përgjegjshme në tender. Sidoqoftë mbetet i pa shpjegueshëm çmimi shumë i lartë i ofertave të këtyre dy kompanive të cilat krahasuar me ofertën që i kanë dhënë AQP-së në tenderin për furnizim me naftë, dallimet janë shumë fish më të larta. Në kontratat që ka sjell kompania fituese në ofertën e saj, në formë të referencave, shihet se institucioneve të tjera kjo kompani u ofron naftë me çmime shumë më të ulëta. Për shembull kjo kompani i shet produktet e naftës Bankës Procredit, me vetëm 0.02 euro premium. Në kontratën e vitit 2011, e njëjta kompani, komunës së Prizrenit i ka shitur produktet e njëjta me çmim prej 0.0001 euro premium për litër.

Sidoqoftë dallimi i çmimit të naftës, përkundër dallimit të çmimeve në premiume, është shqetësues për faktin se institucionet, si komuna e Prizrenit, e cila ka lidhur një kontratë kornizë tre vjeçare, po paguan naftën me çmim shumë më të lartë sesa çmimi i këtij produkti në tregun me pakicë dhe ky është një indikator shumë shqetësues edhe për faktin se nuk është institucioni i vetëm që e bënë këtë.

Gjate monitorimit tonë kemi vërejtur se qasja në çmimin e berzës është shumë problematike, andaj edhe kemi bërë një krahasim shumë të thjeshtë për të dëshmuar mos përputhjen e të dhënave që dorëzojnë kompanitë private për institucionet e Kosovës. Ne për këtë mostër kemi krahasuar berzën e Komunës së Prizrenit, të cilën e ka sjell kompania Petrol Company dhe në anën tjetër kemi marr çmimin e berzës së kompanisë Graniti Petrol. Të dy kompanitë kanë sjell çmimet e berzës për muajin korrik, në mesataren e PLATTS. Ajo çfarë i dallon këto dy çmime të berzës është formati i kalkulimit të çmimit. Përderisa Petrol Company, ka kalkuluar çmimin në një format me 11 njësi, ku ka radhitur çmimet fillestare, taksat, akcizën etj, kompania Graniti ka llogaritur çmimin në 15 njësi. Dallimi i dytë dhe shumë i rëndësishëm është çmimi i naftës pa premium. Në këtë rast, për shkak se të dy kompanitë kanë të njëjtën referencë PLATTS, çmimi është dashur të jetë i njëjtë, për shkak se i referohet mesatares mujore për muajin korrik. Sidoqoftë dallimi është në rreth katër (4) centë. Në këtë rast kompani Graniti ka çmimin mesatar të naftës 1.14812 euro, përderisa Petrol Company çmimin pa Premium e ka 1.1092 euro. Po ashtu tek Petrol Company, çmimi i transportit të

|||||

naftës nuk është i sqaruar, vetëm i referohet ngarkesës nga “Shërbimi Doganor i UNMIK-ut” dhe nuk sqaron ngarkesën monetare për transportin. Në anën tjetër kompania Graniti ngarkon institucionet me 1000 euro për maune me 30.000 litra.

Kjo e dhënë më së miri vë në dukje nevojën për kontratë të centralizuar për furnizim me karburante, për të shmangur çmimet e ndryshme që paguajnë organizatat buxhetore. Mirëpo përderisa kjo të ndodhë nga AQP, atëherë patjetër duhet që një institucion qendror publik të sigurojnë çmimin e karburanteve në mesatare për çdo muaj. Në këtë mënyrë buxhetit të shtetit mund t’i kursehen shumë para vetëm duke u koordinuar më mirë institucionet shtetërore dhe duke i ndarë informacionet.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), nuk e ka rregulluar çështjen e tenderimit të karburanteve dhe në këtë formë, nuk ka një standard se si institucionet e tenderojnë këtë produkt. Disa kërkojnë oferta fikse, disa çmime me Premium, disa te tjera çmime me Premium në të cilën llogaritet edhe çmimi i transportit etj. Ne konsiderojmë se fusha e tenderimit me naftë është pak a shumë kaotike për shkak të mungesës së rregulloreve dhe bazës ligjore përkatëse, për t’u furnizuar me këtë artikull, i cili në tregjet ndërkombëtare mund të ketë ulje apo ngritje në vazhdimësi. Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP), përkundër përgjegjësisë ligjore nuk ka lidhur kontratë të centralizuar për produktet e naftës, e cila do të ishte më e lehtë të mbikëqyrej dhe kontrollohej çmimi dhe cilësia nga institucionet mbikëqyrese, si dhe do të fitohej në vlerë për parane e shpenzuar.

Të gjitha të gjeturat në këtë kontratë për karburante të cilat janë vërejtur si çështje të ndjeshme tek nafta, vlejné edhe për pjesën e furnizimit me benzinë, ku vlejné i njëjti çmim i premiumit dhe janë të përcaktuara të njëjtat kushte të kontratës.

TENDERI PËR NDËRTIMIN E RRUGËS BESËLIDHJA ME KUBZA BETONI

Tenderi i Komunës së Prizrenit për shtrim të rrugës Besëlidhja me kubza betoni, ka koston 6.292.00 euro dhe është një nga tre llojet e tenderëve që do të përcillen në të gjitha komunat. Çmimi i ulët i tenderit, bënë që kjo procedurë tenderuese të mos jetë krejt e zakonshme, pasi që realizohet përmes kuotimit të çmimeve, procedurë standarde ligjore, për ofertat nën 10,000.00 euro. Në këso lloje të procedurave Ligji kërkon një minimum të tre ofertuesve, për të qenë e suksesshme një procedurë e prokurimit. Në këto raste nuk ka njoftim për kontratë i

|||||

dhe qytetarët.

Fenomeni i çmimeve të ulëta në kabëzat e betonit është i zakonshëm në shumë komuna, si pasojë e konkurrencës së madhe ndërmjet operatorëve ekonomik.

KONKLUZIONET

- Çmimet në tenderin e mirëmbajtjes së rrugëve në Komunën e Prizrenit, me gjasë janë të fiksuara nga marrëveshja e bizneseve të cilat kanë ofertuar;
- Konkurrenca në tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve ka qenë shumë e vogël. Rrjedhimisht të tre kompanitë aplikuese kanë fituar nga një llot të tenderit me çmime të njëjta, në lloje të ndryshme;
- Nafta në Komunën e Prizrenit blihet me çmim më të lartë sesa çmimi në tregun me pakicë;
- Premiumi i Kontratës për Furnizim me Naftë është shumë më i lartë sesa paguajnë institucionet e tjera për naftën;
- Në tenderin për naftë ka pasur konkurrencë shumë të kufizuar dhe me gjasë kompanitë aplikuese janë marrë vesh për të aplikuar me çmime të larta;
- Kontrata për shtrim të rrugëve lokale me kubëza betoni, është lidhur me çmim më të ulët sesa vlera në treg. Nevojitet mbikëqyrje e kontratës për të garantuar pranimin e punëve me cilësinë e duhur.



British Embassy
Pristina

Përkrahur nga :

